



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master Shkencor**

Drejtimi: **HISTORI**

**Lënda: MARRËDHËNIET KISHË – SHTET NË EUROPË**  
(NGA MESJETA DERI NË FILLIM TË KOHËS MODERNE)

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Asoc. dr. Ermal BAZE
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Bazë
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

**Përshkrimi:** Historia e Marrëdhënieve midis Kishës dhe Shtetit në Europë nga Mesjeta deri në fillim të kohës moderne, studion raportet institucionale, bashkëpunimin reciprok, aleancat politike dhe rivalitetin midis këtyre dy komponentëve kryesorë të traditës politike europiane dhe të qytetërimit perëndimor.

**Temat e leksioneve:**

1. Hyrje në historinë e marrëdhënieve Kishë – Shtet në Europë përgjatë epokës mesjetare dhe fillimit të kohës moderne. Objekti i studimit të historisë së marrëdhënieve midis Kishës dhe Shtetit. Marrëdhëniet e ndërsjellta dhe aleancat politike midis Kishës dhe Shtetit përgjatë shekujve IV – X. Themelimi i Shteteve Papale.
2. Kisha dhe Feudalizmi (Rëndësia politike e Kishës dhe marrëdhëniet e saj me pushtetet laikë).
3. Zanafilla dhe fillimi i rivalitetit midis Kishës dhe Shtetit (Papati dhe Perandoria gjermane). Revolucioni Gregorian dhe Lufta për Investiturë (shekujt XI – XII).
4. Bashkëpunimi politik midis Kishës dhe Shtetit në kohën e Kryqëzatave.
5. Perandoria e Shenjtë Romake Gjermane dhe Papati në shekujt XII – XIII (Pushteti perandorak dhe universalizmi laik. Papa, perandori dhe qytetet italiane – Guelfët dhe Ghibelinët. Apogjeu i pushtetit papal në kohën e papës Inocentit III dhe supremacia e protagonizmit të tij politik).
6. Kriza e Papatit dhe e Perandorisë (fundi i shekullit XIII – fillimi i shekullit XIV).
7. Skizma e Madhe e Perëndimit (1378 – 1418).
8. Primati i rinovuar i Papatit në gjysmën e dytë të shekullit XV: ripërcaktimi i marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe Kishës (Koncili i Bazelit 1431 – 1449).
9. Kisha dhe Shteti në periudhën e Humanizmit dhe Rilindjes Europiane.
10. Raportet Kishë – Shtet në kohën e Reformacionit Protestant. Idetë e Martin Lutherit dhe Zhan Kalvinit mbi autoritetin shekullar dhe mbi qeverisjen civile.
11. Raportet Kishë – Shtet në kohën e Reformacionit Katolik (Kundërreformës).
12. Pasojat politike të Reformës dhe Kundërreformës (gjysma e dytë e shekullit XVI). Fundi i pretendimeve universaliste të Papatit (gjysma e parë e shekullit XVII).
13. Krishterimi Lindor: Kisha Ruse nën kontrollin e Shtetit përgjatë shekullit XVIII.
14. Kisha Katolike dhe Revolucioni Francez i vitit 1789.

15.Cezaro – Papizmi napoleonik.

**Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II:në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursitose ese:rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

**Literatura e detyrueshme për studentin:**

- 1.J. Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë: Toena, 1997.
2. J. Goff. *Mesjeta në zanafillat e Identitetit European*, Tiranë: SHLK, 2002.
- 3.G. Potesta & G. Vian, *Historia e Krishterimit*, Tiranë: Dituria, 2012.
4. Martin Luther & Jean Calvin, *Mbi autoritetin shekullar dhe mbi qeverisjen civile*, Tiranë: ISP & DITA, 2000.
- 5.I. Gyshe, *Historia e Ideve Politike* (Nga Lashtësia deri në Revolucionin Francez), Pejë: “Dukagjini”, 2005
6. C. McDonald, *Teoria politike Perëndimore*, pjesa I, (Lashtësia dhe Mesjeta), Tiranë: Ideart, 2006.

**Literatura plotësuese:**

- 1.L. Boettner, *Roman Catholicism*, New Jersey: The Presbyterian and Reformed Publishing Company, 1989.
- 2.K. B. Kuiper, *The Church in History*, Michigan: Christian Schools International: EERDMANS, 1995
3. C. Rendina, *I Papi* (Storia e Segreti), Secondaedizione, Roma: GrandiTascabiliEconomici Newton, 1996.
4. H. Chadwick, *The Church in Ancient Society* (From Galile to Gregory the Great), Oxford: Oxford University Press, 2001.
5. A. Agostino, *La Citta di Dio*, Milano: Bompiani, 2001.
6. L. Gatto, *Storia della Chiesa nel Medioevo*, Roma: Newton & Compton Editori, 2001.
7. *The New Cambridge MedievalHistory* (volume I – VII), 500 – 1500, Cambridge: Cambridge University Press, 2005 – 2009.
8. N. Machiavelli, *Princi*, Tiranë: Uegen, 2003.
9. T. More, *Utopia*, Tiranë: Ideart, 2003.
10. D. Erasmus, *Lavdërim i Çmendurisë*, Tiranë: Infbotues, 2004.
11. R. Camileri, *Historia e Vërtetë e Inkuizionit*, Tiranë: Medaur, 2004.
12. Zh. Mere, *Kryeveprat e Mendimit Politik*, Tiranë: “Dita 2000”, 2007.
13. Kolana e shtëpisë botuese Dituria: P. Milza, *Historia e Italisë*, Tiranë: Dituria, 2012. G. Duby, *Historia e Francës*, Tiranë: Dituria 2012. F. De Garcia & J. Gonzalez, *Historia e Spanjës*, Tiranë: 2012. Th. Maissen, *Historia e Zvicrës*, Tiranë: 2013. J. Anisimov, *Historia e Ruisë*, Tiranë: Dituria, 2014. Ph. Chassaingne, *Historia e Anglisë*, Tiranë: Dituria 2015. A. Niederstätter, *Historia e Austrisë*, Tiranë: 2015.

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. dr. Eva TAFILI

Tiranë, 2016